| *2* | *Brother MFP Color Laser Printer DCP-L8410CDË* | *Brother* | *TN-421Y / TN-423Y (Toner)* |
| *3* | *Brother MFP Color Laser Printer DCP-L8410CDË* | *Brother* | *TN-421M / TN-423M (Toner)* |
| *4* | *Brother MFP Color Laser Printer DCP-L8410CDË* | *Brother* | *TN-421BK / TN-423BK (Toner)* |
| *5* | *Xerox VersaLink 7025c* | *Xerox* | *106R03746(Y)* |

| *Nr.* | *Pajisja* | *Marka* | *Modeli i Tonerit* |
|---|---|---|---|
| *6* | *Xerox VersaLink 7025c* | *Xerox* | *106R03747 (magenta)* |
| *7* | *Xerox VersaLink 7025c* | *Xerox* | *106R03748 (cyan)* |
| *8* | *Xerox VersaLink 7025c* | *Xerox* | *106R03745 (Toner BK)* |

*Ky përjashtim zbatohet vetëm për printerat e sipërpërmendur dhe nuk ndikon te pjesa tjetër e pajisjeve për të cilat vazhdojnë të pranohen edhe produkte ekuivalente në përputhje me nenin 23 të LPP.*

*Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje ndryshon nuk ndryshon mbetet data 12.06.2026 ora 10:00*

III.2.2. Neni 2 "*Qëllimi i ligjit*" 162/2021 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, parashikon se:
*Qëllim i këtij ligji është:*
*a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.3. Neni 3 Parime të përgjithshme:
*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.4. Neni 21 "*Autoriteti ose enti kontraktor*" të ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:
*1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti 7 kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.2.5. Nensi 36, “Specifikimet teknike” të ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

*5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.*
*7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.*

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktorë në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktorë duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktorë duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin

mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktorë të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.2.7. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar se qëllimi i ligjit të prokurimit publik, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe i barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kritereve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. K.P.P thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Kriteret e vendosura dhe/ose specifikimet teknike, duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustifikuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në hartimin e kritereve dhe/ose specifikimeve teknike autoritet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast kriteret dhe/ose specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të

zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, dhe në hartimin e kritereve dhe/ose specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vemendje faktin se kriteret dhe/ose specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar.

III.2.9. Referuar ankesës së operatorit ekonomik i cili ngre pretendime mbi specifikimet teknike për tonerat në lidhje me: [….]*Për pajisjet e mëposhtme kërkohet që furnizimi të bëhet ekskluzivisht me tonera/bojra origjinale: 1 2 Brother MFP Color Laser Printer DCP-L8410CDË Xerox VersaLink 7025c Xerox 106R03870?73 Brother TN-421 OR TN-423 Ky përjashtim zbatohet vetëm për printerat e sipërpërmendur dhe nuk ndikon te pjesa tjetër e pajisjeve për të cilat vazhdojnë të pranohen edhe produkte ekuivalente në përputhje me nenin 23 të LPP..*.[...] OE pretendon se janë kërkesa të cilat vijnë në kundërshtim të hapur me nenin 36 të LPP, dhe si të tilla ato duhet të ndryshohen duke përffshirë edhe tonera kompatibël, kjo konform ligjit dukë përfshirë termin "ekuivalent" pra, të lejohen edhe tonerat kompatibël. Komisioni vlerëson se, Autoriteti kontraktor duhet të lejojë edhe Ofertimin me tonera kompatibël, pra tonera "ekuivalentë " , [...] Komisioni pasi u njoh me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike gjykon, se specifikimet teknike duhet të orientojnë drejtë operatorët ekonomikë, duke dhënë informacion të saktë e të mos krijojnë konfuzion në përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave, ashtu dhe tek Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në momentin që bëhet hapja dhe vlerësimi i procedurës. Autoriteti kontraktor në përputhje me parashikimet ligjore, duhet 20 të parashikojë edhe termin ose ekuivalent, përcaktuar në nenin 36/3/4/5 të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, që tonerat në mënyrë alternative mund të jenë origjinale ose ekuivalente çfarë do të thotë, që pjesëmarrës në procedurën e prokurimit mund të jenë si operatorët që i sigurojnë tonerat orgjinalë nga prodhuesi ashtu dhe operatorët që sigurojnë tonera cilësorë, në përputhje kjo edhe me përkufizimin e fjalës ekuivalent nga lex specialis, i cili nënkupton që malli ka karakteristika të barasvlevshme me ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin objekt ankimi në përputhje me konstatimet si më sipër duke përdorur termin ose ekuivalent, pasi për AK është e rëndësishme që tonerat mos të jenë të rimbushur, të kenë paketime të mbyllura dhe me elementë sigurie, kërkesa mëse të justifikuara për të siguruar cilësinë e tyre.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekononomik qëndron.

III 3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik me arsyen se: [...*2 Saktesimi I modeleve dhe sasise per secilin model. Ne shtojcen 7 ne DST FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT nuk ka asnje te dhene ne lidhje me sasine e kerkuar, por eshte percaktuar: Bashkelidhur DST Bashkelidhur DST gjendet dokumenti preventive_tonera.pdf I cili permban ne total 25 artikuj ne total 152 cope. Gjithashtu bashkangjitur gjendet dokumenti specifikime_dhe_preventive.docx ne te cilin gjenden 31 artikuj dhe ne total 150 cope. Gjithashtu bashkangjitur gjendjet dokumenti shtojca_nr_1.docx ku citohet se a) b) Sasia e saktë është Drum Brother HL-L5100DN ? 1 (një) copë. Në preventivin e procedurës duhet të përfshihen edhe artikujt e mëposhtëm: Artikulli Brother DCP-L2600D Drum Brother DCP-L2600D Sasia 3 copë 2 copë Ne kete dokument gjendet e bashkalidhur dhe nje formular ku gjenden te listuara 33 produkte dhe ne total 155 cope. Per sa me siper, kerkojme*

*nga AK perpilimin e sakte te shtojces 7 Formulari I sasise dhe grafikut te levrimit, pasi ka mosperputhje midis formulareve te ngarkuar ne sistem, ne lidhje me sasine per cdo produkt, dhe njesine perkatese cope apo set.*] , Komisioni vë re se,

III. 1.Autoriteti kontraktor ka parashikuar ne preventivin si në vijim grafikun e sasisë dhe të lëvrimit si në vijim:

**BASHKIA SHIJAK**

PREVENTIV

| Nr | Emertimi | SASIA (COPE) | CMIMI | VLERA PA TVSH |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kyocera FS-6525 MFP | 5 | | 0 |
| | Drum Kyocera FS-6525 MFP | 1 | | 0 |
| 3 | Samsung Xpress M2070 | 50 | | 0 |
| | Samsung Xpress M2675 | 3 | | 0 |
| | Drum Samsung Xpress 2675 | 2 | | 0 |
| 4 | HP LaserJet P1606dn | 2 | | 0 |
| 5 | Xerox VersaLink 7025c ngjyra | 9 | | 0 |
| 6 | Xerox VersaLink 7025c zeze | 5 | | 0 |
| 7 | Brother MFC-L2752dw | 3 | | 0 |
| 8 | Drum Brother MFC-L2752dw | 2 | | 0 |
| 9 | Brother HL-L5100dn | 9 | | 0 |
| 10 | Drum Brother L5100DN | 1 | | 0 |
| 11 | Brother DCP-L2600D | 3 | | 0 |
| 12 | Drum Brother DCP-L2600D | 2 | | 0 |
| 13 | HP Color Laser Jet MFP M479 fdn/ngjyra | 3 | | 0 |
| 14 | HP Color Laser Jet MFP M479 fdn/zeze | 4 | | 0 |
| 15 | Drum Lexmark MS510DN | 2 | | 0 |
| 16 | HP LaserJet 135a | 10 | | 0 |
| 17 | Kyocera TASKalfa 3551ci zeze | 5 | | 0 |
| 18 | Kyocera TASKalfa 3551ci ngjyra | 6 | | 0 |
| 19 | Brother MFP Color Laser Printer DCP-L8410CDW ngjyra | 9 | | 0 |
| 20 | Brother MFP Color Laser Printer DCP-L8410CDW zeze | 9 | | 0 |
| 21 | Epson AL- M310dn | 3 | | 0 |
| 22 | Konica Minolta Bizhup 4052 /4020 | 2 | | 0 |
| 23 | Ricoh Aficio MPC 3353 zeze | 2 | | 0 |
| **TOTAL PA TVSH** | | | | **1,666,666** |
| **TVSH** | | | | **333,333** |
| **TOTAL ME TVSH** | | | | **1,999,999** |

*Shtojca 7.*

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

*Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit*

*Sasia e mallit që kërkohet:*

*Afatet e lëvrimit: 20 dite nga data e lidhjes se kontrates*

*Bashkelidhur DST*

III.3.2. *Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: "Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë*

*një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.” Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*”

III.3.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.3.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK për përpilimin saktë të shtojcës 7 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” me formularët e tjerë “Specifikime dhe preventive”( *cituar në pikën III.2.1 të këtëij vendimi),* Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere, që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, duke verifikuar shtojcën e specifikimeve teknike si dhe shtojcën e grafikut dhe sasise dhe lëvrimit, vlerëson se AK duhet të kryejë modifikimin dokumentave, duke unifikuar “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” me formularët e tjerë “Specifikime dhe preventive” si dhe të përcaktojë saktë njësitë përkatësë për artikujt objekt prokurimi në mënyrë që mos krijojë konfuzion për operatorët ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi në momentin e ofertimit. Për këtë arsye autoriteti kontraktor në publikimin e shtojcës duhet të saktësojë saktësojë sasitë dhe njësinë përkatëse për artikujt objekt prokurimi.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III. 4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues me arsyen se : ...[4 *Saktesimin e part number per artikullin Drum Brother DCP-L2600D.*

*Per kete drum eshte kerkuar drum me part number DR2510 I cili nuk pershtatet me printiern DCP-L2600 Sipas te dhenave ne faqen zyrtare te Brother, part number I sakte per kete printer eshteDR-2590https://support.brother.com/g/b/colist.aspx?c=eu_ot&lang=en&prod=dcpl2600d_eu_as&cao=dr Per sa me siper kerkojme saktesimin nese duhet drum DR2510 apo DR2590*] , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, kemi të bëjmë më shumë me kërkesa për sqarime për të cilat autoriteti kontraktor e ka sqaruar dhe nëpërmjet shkresës nr. 3134 prot., datë 09.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1791/1prot., datë 09.06.2026, me objekt “dërgim

vendimi: për procedurën e prokurimit me objekt: "*E hapur e Thjeshtuar*", me Nr. REF-88226-06-01-2026, me objekt "Blerje tonera per printera dhe fotokopje",, me fond limit: 1,666,666.00 lekë pa TVSH, për t'u zhvilluar më datë 12-06-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.
Komisioni gjykon, se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në thelb, janë paqartësi mbi kërkesat e autoritetit kontraktor mbi DRUM Brother DCP-L2600D.P. Në nenin 75 të LPP-së parashikohet shprehimisht se: "Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i 46 dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.", Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti këto sqarime duhet të publikohen në SPE, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së, si më sipër cituar.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*", Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*", Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

**Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "Blueprint Technologies" SHPK, për procedurën e prokurimit ""*E hapur e Thjeshtuar*", me Nr. REF-88226-06-01-2026, me objekt "Blerje tonera per printera dhe fotokopje",, me fond limit: 1,666,666.00 lekë pa TVSH, për t'u zhvilluar më datë 12-06-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Blueprint Technologies" SHPK për procedurën e prokurimit sipër cituar.
3. Autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet dhe sqarimet me shtojcën përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.

4.Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5.Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK.
6.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**
**Fiorent Zguro**

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2026.06.26
02:12:25

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2026/06/26 13:14:05 +02'00'
4948966df983435db5d150a44133b0ea2026062613135631020

- REPUBLIKA E SHQIPËRISË -
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*